

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Neocortex Hub” SHPK

Ne, të nënshkruarit Klevisa Kapo, Gentian Lama, Mimoza Kapo, në cilësinë e ortakëve, bazuar në “Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Ligji Nr.9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, Ligji nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, redaktojmë Aktin e Themelimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Neocortex Hub” sh.p.k, me përmbajtje si më poshtë:

KREU I
Themelimi, Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti

Neni 1

Data: Në Tiranë, sot më datë 25.06.2024, (dymijë e njëzet e katër) ne themeluesit dhe ortakët, vendosëm krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Neocortex Hub” sh.p.k.

Themelues:

Klevisa Besnik Kapo, lindur në Vlorë në 10.05.1998 dhe banuese në Tiranë, me numër ID-je: J85510107Q
Gentian Lutfi Lama, lindur në Tiranë në 26.05.1988 dhe banues në Tiranë, me numër ID-je: I80526053N
Mimoza Remzi Kapo, lindur në Vlorë në 28.08.1969 dhe banuese në Tiranë, me numër ID-je: G95828137T

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “Neocortex Hub” sh.p.k.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria “Neocortex Hub” sh.p.k. është person juridik i të drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”), e themeluar nga ortakët themelues të lartpërmendur, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë vetëm deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota, sipas këtij raporti.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në adresën “*Rruga Themistokli Gërmenji, pallati 4, Tiranë*”. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.



Neni 4
Objekti

Neocortex Hub do të ketë në fokus krijimin dhe qarkullimin e dijes mes organizatave dhe individëve, si edhe prodhimin e vazhdueshëm të produkteve dhe projekteve inovative, edukuese, kulturore, kreative dhe të qëndrueshme, si për shembull një qendër edukimi, aplikacione edukimi, shërbime biznesi, projekte inovative e sociale, etj. Kompania do të themelohet si një hub, i orientuar nga dija, edukimi, kërkimi, inovacioni, industritë kreative, turizmi, ekonomia qarkore, kultura, fëmijët, rinia, sipërmarrja e të tjera drejtime strategjike të kohës dhe ekonomisë. Aktiviteti do të mbështetet në 2 shtylla kryesore. Shtylla 1: Ndërlidhja, fuqizimi, prodhimi dhe shpërndarja e dijes mes aktorëve të ekosistemeve të startupeve, bizneseve, dijes dhe inovacionit në Shqipëri dhe ndërkombëtarisht. Kjo do të arrihet nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të biznesit, si shkruajta e projekt-propozimeve për grante, menaxhimi dhe implementimi i përbashkët i projekteve, kërkimi i tregut, studimet, trajnimet, konsultimet për përgatitjen e planeve të biznesit, strategjive të inovacionit e komunikimit, zhvillimit të biznesit, marketingut, analizës së të dhënave, trajnimeve dhe konsulencave të ndryshme të biznesit, etj. Shtylla 2: Si një hub i bazuar në inovacion, kërkim, kreativitet dhe qarkullimin e dijes, Neocortex Hub do të prodhojë produkte dhe projekte në vazhdimësi vetëm ose në bashkëpunim, të cilat mund të jenë afatshkurtra ose afatgjata. Produktet / projektet e qëndrueshme afatgjata, kur të maturohen mund të shpëputen si entitete / startupe më vete. Produktet mund të jenë të prekshme, digjitale ose në formën e shërbimeve.

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendrën Kombëtare të Biznesit.

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është **300 lekë** (treqind lekë) dhe është i përbërë nga 3 kuota.

Kapitali i mësipërm nënshkruhet dhe shlyet tërësisht në të holla nga ortakët e shoqërisë. Përkatësisht:

Klevisa Kapo zotëron 1 kuotë, me vlerë të përgjithshme 30 lekë, që përbën 10% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Gentian Lama zotëron 1 kuotë, me vlerë të përgjithshme 30 lekë, që përbën 10% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Mimoza Kapo zotëron 1 kuotë, me vlerë të përgjithshme 240 lekë, që përbën 80% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.
- Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).
- Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cënimit.



Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar. Projekti i transferimit i njoftohet shoqërisë dhe secilit prej ortakëve. Në rast se shoqëria nuk ka bërë të ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit të fundit sipas paragafit të mësipërm, miratimi i transferimit konsiderohet i dhënë. Në rast se shoqëria refuzon të japë miratimin e transferimit, ortakët, brenda tre muajve nga data e këtij refuzimi, duhet të blejnë apo të lejojnë blerjen e pjesëve të kapitalit themeltar me vlerën e përcaktuar sipas rregullave të nenit 11 të këtij ligji. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës


Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.



Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e Përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e të paktën tri të katërtave të zotëruesve të kapitalit të shoqërisë, që janë pjesëmarrës në mbledhje.

Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB-së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 10

Administrimi

- Shoqëria do të administrohet nga një administrator.
- Administratore e shoqërisë do të jetë **Znj. Klevisa Kapo**, e cila do të ushtrojë funksionet në këtë detyrë për një periudhë 5 vjeçare.
- Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.
- Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdo njërit prej ortakëve.
- Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë QKB-së.
- Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në QKB.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecures së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

e) raportoje përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe në rastet kur:

- Asambleja e Përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% të asetëve të shoqërisë që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.

Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjitha personave fizikë e juridikë, publik dhe / ose privat vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 13

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në QKB;
- d) me vendim të gjykatës.

Në këtë rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindi midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Ngarkohet dhe autorizohet **Administratorja Klevisa Kapo**, për depozitim të akteve pranë QKB.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “Neocortex Hub” sh.p.k.

Klevisa Kapo

Klevisa Kapo



Gentian Lama

Gentian Lama



Mimoza Kapo

Mimoza Kapo.

